



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 16.01.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 15:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 3. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 6. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 7. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”.

Maksim Qoku: Atëherë, fillojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës. 2.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit

Korçë”.

Fjala për ju zoti Toska!

Ilir Toska: Mirë atëherë, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është përgatitur një projektvendim në kushtet kur Gjykata e Apelit Korçë aktualisht ka vetëm 2 gjyqtarë, që do të thotë që ajo është tashmë jashtë funksionit për të gjykuar çdo lloj çështjeje që paraqitet përpara saj. Për rrjedhojë është bërë e nevojshme që ne të adoptojmë disa rregulla në zbatim të vendimit të mëhershëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, kjo për faktin se nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë janë specifike. Tashmë kemi gati të gjitha çështjet që paraqiten në Gjykatën e Apelit Korçë do të kërkojnë nevojën për t’u plotësuar trupi gjykues, për rrjedhojë kemi menduar që t’i japim zgjidhje nevojës imediate që ka të bëjë me çështjet për caktim, zëvendësim, revokim, bashkim ose shuarje të masës së sigurimit në lëndë penale, për të cilat do duhet të bëjmë një listë gjyqtarësh nga gjykata të tjera të apelit, për çdo periudhë 10-ditore, ata të plotësojnë trupat gjykues për këto lloj çështjesh.

Kemi parashikuar edhe një lloj rregullimi sa i përket edhe anomalive që mund të lindin gjatë gjykimin të këtyre çështjeve, nëse gjyqtari i caktuar që ne kemi propozuar të bëhet mbi bazën e shortit për periudhën 10-ditore, nuk është në detyrë për arsye të ndryshme, në vend të tij, automatikisht të vijë gjyqtari që renditet më pas në listë.

E njëjti rregull kemi propozuar edhe në rastet kur një prej dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, që janë në detyrë, ka papajtueshmëri për të gjykuar çështje të kësaj natyre, apo çështje konkrete, edhe në atë rast, kemi propozuar të zbatohet i njëjti rregull për atë gjyqtar që është më pas në listë, të zëvendësojë gjyqtarin që ka papajtueshmëri, qoftë njërin apo të dy gjyqtarët, në atë rast do duhet të dy gjyqtarët që janë renditur më pas në listë.

Ndërkohë, sa i përket kërkesave që Gjykata e Apelit Korçë paraqet përpara Këshillit, në zbatim të vendimit 30 të vitit 2019, kemi adaptuar dy rregulla të ndryshme, një për sa i përket kërkesave që kanë të bëjnë me persona të paraburgosur, pra që janë

çështje sensitive dhe Këshilli do duhet të operojë me shpejtësi dhe kërkesa për çështje të tjera, që nuk përfshihen tek ato me persona të paraburgosur, për të cilat Këshilli do duhet të konsiderojë rast pas rasti duke pasur në konsideratë që të mos dërgojë vazhdimisht gjyqtarë nga gjykatat e tjera të apelit në Gjykatën e Apelit Korçë, për të ruajtur edhe në gjykatat mëmë nga ata janë të njëjtin standard për sa i përket afateve të gjykimit. Gjykata e Apelit Korçë nuk ka ngarkesë të lartë dhe praktikisht, në momentin që çështja regjistrohet në gjykatë, menjëherë nxirret për gjykim. Ndërkohë që, në të gjitha gjykatat e tjera të apelit, çështjet presin me muaj apo vite, për të bërë një balancim të tyre interesave të shtetasve që paraqiten para Gjykatës së Apelit Korçë apo në gjykatat e tjera të apelit, kemi konsideruar që Këshilli të konsiderojë rast pas rasti trajtimin e kërkesave që do na vijnë nga Gjykata e Apelit Korçë, mbi bazën e informacionit që do të paraqesë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çdo muaj përpara Këshillit. Pra do të jetë Këshilli që do të vlerësojë në fund momentin kur do duhet t'i trajtojë të gjitha kërkesat që vijnë nga Gjykata e Apelit Korçë për çështje jo të natyrës sensitive apo urgjente.

Përpara keni edhe projektvendimin.

Nuk e di nëse është e nevojshme të lexoj vet apo do ta lexojë dikush.

Nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët...

Faleminderit!

Maksim Qoku: Atëherë, nëse nuk ka diskutime për pas parashtrimin që bëri relatori i çështjes, mund të kalojmë në votim të projektvendimit.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Fjala për ju zoti Toska!

Ilir Toska: Sipas vendimit që miratuam, në të cilën është vendosur që, Këshilli ka vendosur të urdhërojë urdhërimin:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kushtet kur Gjykata e Apelit Korçë është jashtë funksioni për shkak të mungesës së numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë, nevojat dhe kërkesat e saj për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta, deri në momentin e bërjes funksionale të kësaj gjykate, do të trajtohen si më poshtë:

a) Për çështjet që kanë të bëjnë me caktim, zëvendësim, revokim, bashkim ose shuarje të masave të sigurimit në lëndë penale, që do të regjistrohen deri më datë 31.07.2020, Këshilli miraton menjëherë, mbi bazën e shortit, një listë gjyqtarësh nga gjykatat e tjera të apelit, për çdo periudhë 10-ditore. Këshilli rishikon dhe përditëson listën e gjyqtarëve kur është e nevojshme.

b) Për çështjet sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur gjyqtari i caktuar sipas rregullit të kësaj shkronje nuk është në detyrë në periudhën 10-ditore përkatëse ose në rastin kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur për të dy gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta. Në këtë rast, krahas gjyqtarit të caktuar për periudhën respektive, trupi gjykues formohet edhe nga dy gjyqtarët që gjenden të renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Gjyqtari sipas situatës së parë të kësaj shkronje, kur është e mundur, përmbush detyrën në periudhën 10-ditore pasuese. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit/gjyqtarëve zëvendësues.

c) Kërkesat për caktim gjyqtari për çështjet që kanë të bëjnë me persona të

paraburgosur në lëndë penale, si dhe për çështjet civile për të cilat ligji ka parashikuar afate të shkurtra gjykimi, do të trajtohen nga Këshilli sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, në mënyrë periodike, brenda afateve të arsyeshme.

ç) Kërkesat për caktim gjyqtari të ndryshme nga ato sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, përfshirë edhe ato për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, do të trajtohen nga Këshilli sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, në mënyrë periodike, brenda afateve të arsyeshme, në varësi të numrit të kërkesave dhe duke respektuar parimin e barazisë përpara ligjit të shtetasve sa i përket të drejtës për të patur një gjykim të çështjes së tyre brenda një afati të arsyeshëm. Këshilli vendos për kohën e trajtimit të këtyre kërkesave, pas informacionit të marrë çdo muaj nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjykatave të apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Referuar këtij urdhërimi që miratua, sipas pikës “a”, ne do duhet të zhvillojmë shortin për të përcaktuar listën e gjyqtarëve që do të caktohen menjëherë për të plotësuar trupin gjykues në Gjykatën e Apelit Korçë, sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me caktimin, zëvendësimin, revokimin, bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit në lëndë penale.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoit Toska!

Tani, procedojmë me shortin.

Ilir Toska: Atëherë, në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve të gjykatave të apelit. Mundet të vendosim bashkërisht tani se kush do të jenë emrat e gjyqtarëve të apelit që do përfshihen në short, si rregull kemi ndjekur që kryetarët në detyrë të gjykatave të apelit, të mos i përfshijmë në short në rastet e caktimit për çështjet gjyqësore të veçanta. Mund ta konsiderojmë përsëri të njëjtin rregull.

Dhe e dyta, nëse ka ndonjë nga anëtarët ndonjë mendim për përjashtim tjetër të gjyqtarëve.

Atëherë mendoni që duhet të përjashtojmë kryetarët në detyrë të gjykatave të

apelit dhe gjyqtaren Miranda Andoni të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që është edhe anëtarë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Atëherë do të përjashtojmë emrat e 6 gjyqtarëve. Të tjerët do të marrin pjesë në short, që më rezultojnë 36.

Mund t'i lexojmë emrat që do t'i fusim në një enë dhe për çdo periudhë 10-ditore do të zgjedhim emrin e një gjyqtari.

Valbona Bako: Atëherë, nga apeli Tiranë: Andi Civici, Fatmira Hajdari, Valdete Hoxha, Genti Shala, Shpresa Beçaj, Alaudin Malaj, Shkëlqim Mustafa, Elona Toro, Elbana Lluri, Artur Gaxhi, Artur Kalaja, Maria Qirjazi, Gramoz Levanaj, Asim Vokshi, Edlira Petri, Flutura Skënderi dhe Zegjine Sollaku.

Nga apeli Durrës: Izet Dushaj, Valbon Çekrezi, Tritan Hamitaj dhe Anita Mici.

Apeli Shkodër: Lindita Hoxha, Valbona Vata, Selim Kryeziu, Aleks Nikolli, Vojsava Osmanaj.

Apeli Gjirokastrë: Enton Dhimitri, Irena Brahimi dhe Izet Salaj.

Apeli Vlorë: Hysen Saliko, Margarita Buhali, Nazmi Troka, Petrit Aliaj, Skënder Damini, Sokol Ngresi dhe Klodiana Gjizari.

Ilir Toska: Përpara se të fillojmë të tërheqim emrat për gjyqtarët, përpara keni të gjitha informacionet në lidhje me gatishmërinë që gjyqtarët kanë në gjykatat nga ata vijnë. Do ta verifikojmë rast pas rasti. Nëse periudha që i bije në shortin tonë i korrespondon periudhës kur është në listë gatishmërie në gjykatën e vetë, do të duhet ta përsërisim shortin, të gjejmë një gjyqtar tjetër, që mos të përplasim periudhat e gatishmërisë.

Faleminderit atëherë. Përzieri letrat dhe zgjidhni emrin.

Shorti fillon, periudha e parë është nga sot. Në fakt, në informacionin që kemi marrë nga Gjykata e Apelit Korçë ka një çështje që është regjistruar para disa ditësh por që nuk është shqyrtuar. Kështu që i bie që do duhet të shqyrtojmë edhe atë çështje që është regjistruar këtë vit por nuk është realizuar nga gjykimi nga treshja që ka qenë. Është shtyrë dhe do duhet ta... Periudha e parë. E fundit është 31 korriku.

Valbona Bako: Asim Vokshi.

Ilir Toska: Atëherë, okej. Vazhdojmë. Periudha e parë deri më datë 24 janar, emri i gjyqtarit të përzgjedhur nga shorti është Asim Vokshi i Gjykatës së Apelit Tiranë, vazhdojmë me emrin tjetër.

Valbona Bako: Nazmi Troka.

Elona Toro.

Ilir Toska: Gjatë të njëjtës periudhë gjyqtarja Elona Toro është në gatishmëri edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ajo ushtron funksionet. Do ta ripërsëritim shortin.

Të vazhdojmë të zgjedhim për periudhën 4 shkurt -13 shkurt.

Valbona Bako: Zegjine Sollaku.

Ilir Toska: Për periudhën 4 shkurt – 13 shkurt emri i përzgjedhur nga shorti është Zegjine Sollaku e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën tjetër 14 shkurt –23 shkurt.

Valbona Bako: Tritan Hamitaj.

Ilir Toska: Për periudhën 14 shkurt - 23 shkurt emri i përzgjedhur nga shorti është Tritan Hamitaj, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Durrës.

Vazhdojmë për periudhën tjetër që është 24 shkurt - 4 mars.

Valbona Bako: Aleks Nikolli.

Ilir Toska: Atëherë për periudhën 24 shkurt - 4 mars është përzgjedhur emri i gjyqtarit Aleks Nikolli i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vazhdojmë për periudhën tjetër 5 mars - 14 mars, 5 mars deri 14.

Valbona Bako: Valbon Çekrezi.

Ilir Toska: Është i gatshëm. Atëherë në këtë periudhë është i gatshëm në gjykatën e vet, do të duhet të përsëritim shortin.

Valbona Bako: Selim Kryeziu.

Ilir Toska: Për periudhën 5 mars – 14, emri i përzgjedhur nga shorti është emri i gjyqtarit Selim Kryeziu i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me procedurën e shortit për periudhën 15 mars - 24 mars.

Valbona Bako: Gramoz Levanaj.

Ilir Toska: Atëherë, për periudhën 15 mars - 24 mars u përzgjedh nga shorti gjyqtari Gramoz Levanaj i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën tjetër 25 mars - 3 prill.

Valbona Bako: Valdete Hoxha.

Ilir Toska: Për periudhën 25 mars - 3 prill emri i përzgjedhur nga shorti gjyqtarja Valdete Hoxha e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me periudhën tjetër 4 prill - 13 prill.

Valbona Bako: Sokol Ngresi.

Ilir Toska: Atëherë, për periudhën 4 prill - 13 prill emri i përzgjedhur nga shorti është Sokol Ngresi i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me periudhën tjetër 14 prill - 23 prill.

Valbona Bako: Andi Civici.

Ilir Toska: Emri i përzgjedhur nga shorti për periudhën 14 prill - 23 prill është gjyqtari Andi Civici i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën 24 prill - 3 maj.

Valbona Bako: Artur Gaxhi.

Ilir Toska: Emri i përzgjedhur nga shorti për periudhën 24 prill - 3 maj është Artur Gaxha, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën tjetër 4 maj deri më 13 maj.

Valbona Bako: Genti Shala.

Ilir Toska: Emri i përzgjedhur nga shorti për periudhën 4 maj deri 13 maj është Genti Shala i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën tjetër 14 maj - 23 maj.

Valbona Bako: Irena Brahim.

Ilir Toska: Gjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë e gatshme në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë ku ushtron funksionin. Do të duhet ta ribëjmë shortin.

Valbona Bako: Edlira Petri.

Ilir Toska: E përsëritim shortin se e prek.

Valbona Bako: Margarita Buhali.

Ilir Toska: Për periudhën 14 maj - 23 maj emri i përzgjedhur është Margarita Buhali e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Vazhdojmë për periudhën 24 maj - 2 qershor.

Valbona Bako: Elbana Lluri.

Ilir Toska: Emri i përzgjedhur nga shortin për periudhën 24 maj - 2 qershor është Elbana Lluri e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën 3 qershor - 12 qershor.

Valbona Bako: Alaudin Malaj.

Ilir Toska: Atëherë për periudhën 3 qershor - 12 qershor emri i përzgjedhur është Alaudin Malaj i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën 13 qershor - 22 qershor.

Valbona Bako: Fatmira Hajdari.

Ilir Toska: Atëherë për periudhën 13 qershor - 22 qershor emri i përzgjedhur është Fatmira Hajdari e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë për periudhën 23 qershor - 2 korrik.

Valbona Bako: Shkëlqim Mustafa.

Ilir Toska: Atëherë emri i përzgjedhur nga shorti për periudhën 23 qershor - 2 korrik është Shkëlqim Mustafa i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me periudhën 3 korrik - 12 korrik.

Valbona Bako: Izet Dushaj.

Ilir Toska: Atëherë për periudhën 3 korrik - 12 korrik emri i përzgjedhur është Izet Dushaj i Gjykatës së Apelit Durrës.

Vazhdojmë me periudhën 13 korrik - 22 korrik.

Valbona Bako: Izet Salaj.

Ilir Toska: Atëherë për periudhën 13 korrik - 22 korrik emri i përzgjedhur nga shorti është Izet Salaj i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Dhe periudha e fundit 23 korrik - 31 korrik.

Valbona Bako: Maria Qirjazi.

Ilir Toska: Emri i fundit i përzgjedhur nga shorti për periudhën 23 korrik - 31

korrik është Maria Qirjazi e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Maksim Qoku: Atëherë, kalojmë në miratimin e listës së...

Këshilli vendosi miratimin e listës së gjyqtarëve të gjykatave të apelit që caktohen për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë çështje që kanë të bëjnë me caktimin, zëvendësimin, revokimin, bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit në lëndë penale, të regjistruar gjatë periudhës deri më datë 31.07.2020 si më poshtë (për periudhat):

15.01.2020 – 24.01.2020 gjyqtari Asim Vokshi;
25.01.2020 deri 03.02.2020 gjyqtari Nazmi Troka;
04.02.2020 deri më datën 13.02.2020 Zegjine Sollaku;
14.02.2020 - 23.02.2020 gjyqtarit Tritan Hamitaj;
24.02.2020 – 04.03.2020 gjyqtari Aleks Nikolli;
05.03.2020 – 14.03.2020 gjyqtari Selim Kryeziu;
15.03.2020 deri 24.03.2020 gjyqtari Gramoz Levanaj;
25.03.2020 - 03.04.2020 gjyqtare Valdete Hoxha;
04.04.2020 -13.04.2020 gjyqtari Sokol Ngresi;
14.04.2020 – 23.04.2020 gjyqtari Andi Civici;
24.04.2020 - 03.05.2020 gjyqtari Artur Gaxha;
04.05.2020 – 13.05.2020 gjyqtari Genti Shala;
14.05.2020 – 23.05.2020 gjyqtare Margarita Buhali;
24.05.2020 – 02.06.2020 gjyqtare Elbana Lluri;
03.06.2020 – 12.06.2020 gjyqtar Alaudin Malaj;
13.06.2020 – 22.06.2020 gjyqtare Fatmira Hajdari;
23.06.2020 – 02.07.2020 gjyqtari Shkëlqim Mustafa;
03.07.2020 – 12.07.2020 gjyqtari Izet Dushaj;
13.07.2020 – 22.07.2020 gjyqtari Izet Salaj;
dhe 23.07.2020 - 31.07.2020 gjyqtare Maria Qirjazi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare dhe një kopje t'iu njoftohet gjyqtarëve dhe Gjykatës së Apelit Korçë. Ju faleminderit!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 16.01.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 15:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 3. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 6. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 7. Valbona Bala, USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Maksim Qoku: Atëherë kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës që është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ato ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Relatimi nga kryetarit i Karrierës.

Zoti Toska, fjala për ju!

Ilir Toska: Atëherë deri ditën e djeshme, nga Gjykata e Lartë kanë mbërritur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor dy kërkesa për caktim gjyqtari, në dy çështje që kanë të bëjnë me ekstradimet.

Si dhe në rastet e mëhershme, Këshilli ka konsideruar të zbatojë Vendimin e tij nr.

30 të vitit 2019 dhe propozimi i Komisionit është që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Numri i gjyqtareve të jetë dy, aq sa është nevoja. Por që këta gjyqtarë duhet të plotësojnë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr.84 të vitit 2016. Dhe nga lista e gjyqtarëve që kanë kaluar vetingun, procesin e rivlerësimit dhe që kanë përvojën përkatëse 13 vjet, si më lart u përmend, janë gjyqtarët Nertina Kosova, Albana Boksi, Dhimitër Lara, Anton Dhimitri, Margarita Buhali, Saida Dollani, Sokol Binaj dhe Artur Kalaja Është dhe gjyqtari Astrit Kalaja, por në rastin konkret ka pengesë ligjore për gjykimin e dy çështjeve që janë në nevojë përpara Gjykatës së Lartë.

Jeni dakord me propozimet e komisionit?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ilir Toska : Atëherë do të duhet të procedojmë me short elektronik.

Valbona Bako. Saida Dollani dhe Sokol Binaj për të dyja çështjet.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për të dy çështjet.

Maksim Qoku: Faleminderit për pjesëmarrjen.

Takohemi në mbledhjet e ardhshme.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor